



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 29.10.2018

Dokument parlamentar

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN “PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 125/2013 “PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”, TË NDRYSHUAR”””

HYRJE

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”, në mbledhjen e datës 29 tetor 2018.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Rakip Suli relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”, është një nismë e një grupi deputetësh, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është propozimi i ndryshimeve në ligjin 125/2013, me synim përfshirjen e Konceptit të “Vlerësimit të Alternativës” në aktin bazë që rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktues, për të hyrë në marrëveshje koncesionesh/partneritetesh publike private, për investime të bazuara në koncesione/partneritete publike, përfshirjen e aktorëve të tjerë në dhënien e këtij vlerësimi, si dhe parashikimin e përfshirjes së Kuvendit të Shqipërisë në dhënien e miratimit për procedurat koncesionare me kohëzgjatje mbi 4 vjet.

Me qëllim përfshirjen e konceptit të “vlerësimit të alternativës”, projektligji propozon:

1. Të bëhen ndryshime në nenin 3 të ligjit, duke vendosur përkufizimin e tij, si një vlerësim paraprak i studimit të fizibilitetit që kryhet nga Autoriteti Kontraktues në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Ministrinë që mbulon çështjet e ekonomisë dhe Avokaturën e Shtetit.
2. Të bëhen ndryshime në nenin 18, i cili përcakton detyrat e Komisionit të Koncesionit/partneritetit publik privat, duke përcaktuar dhe procedurën e dërgimit për dhënie të vlerësimit të alternativës tek ministrinë e sipër përmendura .
3. Të bëhen disa shtesa në nenin 19, ku të përcaktohet procedura që do të ndiqet për marrjen e mendimit të ministrisë së financave, asaj të ekonomisë dhe avokatura e shtetit.

II. PROCESI I SHQYRTIMIT NË KOMISIONIN PËR VEPRIMTARITË PRODHUESE, TREGTINË DHE MJEDISIN

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrtoi projektligjin në mbledhjen e datës 29 tetor 2018.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komision relatori i njohu deputetët me faktin se ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përfunduar hartimin e një projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik/privat, të ndryshuar”. Ky projektligj ndodhet në fazën e konsultimit publik, është publikuar në regjistrin elektronik të konsultimit publik¹ dhe së shpejti do t’i dërgohet për miratim Kuvendit. Ndryshimi i kuadrit institucional i parashikuar në projektligjin e hartuar nga ministria e Financave dhe Ekonomisë, ndër të tjera, do të bëjë të mundur edhe përgatitjen me cilësi të studimit të fizibilitetit i cili përbën thelbin e rezultateve dhe suksesit të një projekti koncesioni/PPP.

Në këto kushte, relatori u shpreh se ndryshimet në ligj të propozuara nga grupi i deputetëve nismëtarë konsiderohen jo efektive dhe i propozoi Komisionit të mos i miratojë ato.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicë votash vendosi mosmiratimin e projektligjit. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm.

RELATOR

KRYETAR

Rakip SULI

Eduard SHALSI

¹ <http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/76>